REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E DREJTËSISË

AGJENCIA E MBIKËQYRJES NË SISTEMIN E EKZEKUTIMIT TË VENDIMEVE PENALE

Shpallje e vendeve vakante të punës

Agjencia e Mbikëqyrjes në Sistemin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale, me Urdhër nr.405, datë 02.11.2026 të Drejtorit të Përgjithshëm, shpall vendet vakante për pozicionet e punës si më poshtë:

- 1 vend vakant për pozicionin "Inspektor pranë IEVP Pojskë" -punonjës operacional,
- 1 vend vakant për pozicionin "Inspektor pranë IEVP Tepelenë" -punonjës operacional,
- 1 vend vakant për pozicionin "Inspektor/specialist i teknikës" -punonjës operacional,
- 2 vende vakante për pozicionin "Agjent/vëzhgues terreni"-punonjës operacional.

KRITERE TË PËRGJITHSHME

Për vendet e shpallura vakante, aplikantët duhet të përmbushin kriteret e përgjithshme të pranimit në Agjenci si më poshtë vijon:

a) është shtetas shqiptar;
b) ka zotësi të plotë për të vepruar;
c) përmbush kërkesat për nivelin e arsimit, njohuritë e posaçme profesionale dhe përvojën e nevojshme sipas vendit të punës e të funksionit;
ç) është në kushte shëndetësore dhe fizike që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse;
d) nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale;
dh) nuk është në procedim penal për një vepër penale të kryer me dashje, që cenon pozitën dhe figurën e Agjencisë;
e) ndaj tij nuk është marrë masa disiplinore e largimit nga puna ose nuk ka masë disiplinore në fuqi;
ë) nuk është përjashtuar nga strukturat e Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore apo nga struktura të tjera të ngjashme për shkak të vlerësimit kalimtar ose periodik sipas legjislacionit të posaçëm;
f) të plotësojë kriteret për pajisje me CSP;
g) duhet të zotërojë të paktën diplomë të nivelit "Bachelor", të dhënë nga institucionet e arsimit të lartë, përfshirë edhe ato me status të veçantë, me veprimtari në fushën e rendit e të mbrojtjes, apo diplomë të barasvlershme me të, të marrë në institucione të tjera të vendit ose të huaja, dhe të njohur e të ekuivalentuar, sipas legjislacionit në fuqi për arsimin e lartë.

KRITERE TË POSAÇME:

1-për kategorinë punonjës operacional: inspektor në IEVP Pojskë, inspektor në IEVP Tepelenë, inspektor/specialist i teknikës dhe agjent/vëzhgues terreni, aplikantët duhet të plotësojnë kriteret e posaçme si më poshtë:

Punonjësit operacionalë, të cilët kryejnë funksionet e oficerit të Policisë Gjyqësore, para se të pranohen në Agjenci në strukturat operacionale, duhet të kenë përvojë pune jo më pak se 5 (pesë) vjet në të paktën një nga këto struktura:

a) seksionet e Policisë Gjyqësore pranë prokurorive me juridiksion të përgjithshëm;

b) strukturat e hetimit të Policisë së Shtetit;

c) Byronë Kombëtare të Hetimit;

ç) strukturat në institucionet shtetërore, të cilave ligji i posaçëm u njeh atributet e Policisë Gjyqësore; ose

d) strukturat informative të Shërbimit Informativ të Shtetit, Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes, si dhe Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore apo çdo strukturë tjetër e ngjashme informative apo shërbime të tjera policore.

Kandidatët që plotësojnë kriteret e mësipërme i nënshtrohen procesit të konkurrimit.

PROCEDURA E APLIKIMIT PËR VENDET E SHPALLURA VAKANT

-Aplikanti dërgon në rrugë elektronike në adresën info@amsevp.gov.al ose pranë sekretarisë/protokollit të Drejtorisë së Agjencisë së Mbikëqyrjes në Sistemin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale, me adresë: Rruga. Mihal Duri, Tiranë:

1. Kërkesë për vendin vakant,
2. CV (jetëshkrim),
3. Fotokopje të kartës së identitetit,
4. Kopje origjinale ose fotokopje e noterizuar e cikleve të studimit, shoqëruar me listë-notash,
5. Çertifikatë e gjendjes gjyqësore (dëshmi penaliteti),
6. Dy fotografi me përmasa 4X6,
7. Vërtetim nga përmbarimi gjyqësor, prokuroria dhe gjykata që nuk është në ndjekje penale,
8. Raport mjeko-ligjor mbi gjendjen shëndetësore,
9. Dokumente që vërtetojnë përvojën e punës,

AFATI PËR FILLIMIN DHE PËRFUNDIMIN E APLIKIMIT

Afati i aplikimit fillon në **datë 02.11.2026 dhe përfundon në datë 16.11.2026.**

Pas kësaj date nuk pranohen më aplikime.

Aplikantët e përzgjedhur pas verifikimit të dokumentacionit, do të njoftohen në rrugë elektronike për procedurën përkatëse në vijim, testim me shkrim/testim me gojë.